



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.legjislacioni.gov.al](http://www.legjislacioni.gov.al)

**Nr.83**

**Datë 6 qershor 2014**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i Kuvendit nr. 37/2014 datë 29.5.2014	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 26, datë 24.4.2014, “Për krijimin e komisionit hetimor të Kuvendit për hetimin e akuzave mbi implikimin e Forcave të Armatosura dhe bazave ushtarake në veprimtari të kundërligjshme - transportin e lëndëve narkotike”, të ndryshuar .....	3369
Rezolutë e Kuvendit datë 29.5.2014	Për vlerësimin e veprimitarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2013 .....	3369
Njoftim i Kuvendit	Për vend pune .....	3370

**VENDIM**  
**Nr. 37/2014**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E**  
**KUVENDIT NR. 26, DATË 24.4.2014, "PËR**  
**KRIJIMIN E KOMISIONIT HETIMOR TË**  
**KUVENDIT PËR HETIMIN E AKUZAVE MBI**  
**IMPLIKIMIN E FORCAVE TË ARMATOSURA**  
**DHE BAZAVE USHTARAKE NË VEPRIMTARI**  
**TË KUNDËRLIGJSHME - TRANSPORTIN E**  
**LËNDËVE NARKOTIKE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës, të nenit 9, të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit", si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Deputeti Xhemal Qefalia zëvendësohet me deputetin Anduel Xhindi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Ilir META**

Miratuar në datë 29.5.2014

**REZOLUTË**  
**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË**  
**AUTORITETIT TË KONKURRENCËS**  
**PËR VITIN 2013**

**Kuvendi i Shqipërisë konstaton se:**

Veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës është ushtruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9121, datë 29.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", ndryshuar me ligjin nr. 9499, datë 3.4.2006.

**Kuvendi vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës në drejtim të:**

- Rritjes së besueshmërisë, të shprehur nëpërmjet numrit të çështjeve të ankmuara pranë Autoritetit të Konkurrencës;

- Rritjes së efikasitetit, të shprehur përmes numrit të çështjeve të trajtuara nga Autoriteti i Konkurrencës;

- Konsolidimit të profilit të tij publik, si institucion që mbron interesat e biznesit, nëpërmjet zbatimit të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës;

- Punës në vijimësi për të përafëruar kuadrin ligjor me atë të vendeve të Bashkimit Europian;

- Punës në vijimësi për të përmirësuar kuadrin ligjor në fushën e konkurrencës;

- Punës në vijimësi për të rritur monitorimin në treg;

- Hartimit të dokumentit të ri të politikës së konkurrencës, në bashkëpunim me institucionet vendase dhe të huaja, komunitetin e biznesit dhe shoqatat konsumatore;

- Objektivit për të rritur kapacitetin e stafit të Autoritetit të Konkurrencës, për të pasur një rol më proaktiv në zgjidhjen e problemeve të marrëveshjeve të ndaluara, praktikave antikonkurrese dhe abuzimit me pozitën monopolistike.

**Kuvendi kërkon që Autoriteti i Konkurrencës, për vitin 2014, të përmirësojë punën në drejtim të:**

1. Fokusimit të veprimtarisë në sektorët më prioritarë të ekonomisë, ku përqendrimi i tregut në subjekte të caktuara ka sjellë deformime të funksionimit të tregjeve, si:

*Tregu i telefonisë celulare*

- Tregu i telefonisë celulare është paraqitur problematik, pasi shihet një fenomen antikonkurrese, që lidhet me diferencimin e theksuar të tarifave të thirrjeve brenda rrjetit dhe atyre jashtë rrjetit nga operatorët e konsoliduar në treg, pavarësisht se kostot janë të përafërta. Ky fenomen, i cili kushtëzon sjelljen e konsumatorit dhe shkakton impakt negativ për konkurrencën e lirë, ka sjellë që numri i thirrjeve brenda rrjetit të jetë në nivelin më të lartë në botë (97 për qind e thirrjeve brenda rrjetit, ku Kenia është e dyta me 96 për qind) dhe në përqendrim të tregut, ku një kompani e vetme ka rreth 50 për qind të tregut dhe dy kompanitë e para rreth 90 për qind. Për të zgjidhur këtë situatë, e cila krijon mure në treg, duke penguar konkurrencën, Kuvendi i kërkon Autoritetit të Konkurrencës që të intensifikojë bashkëpunimin me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

*Tregu i sigurimeve*

- Në këtë treg, rënia e shpejtë e çmimeve, pas liberalizimit në nivele shumë të ulëta dhe jokonkurrese, cilësim ky që vjen si nga aktorët në treg, ashtu dhe nga organet mbikëqyrëse kompetente, nuk është zgjidhur, duke diversifikuar produktin, sipas modelit të propozuar (bonus-malus), por është bërë duke koordinuar rritjen e çmimit.

*Energjia*

- Zbatimi i vendimeve të mëparshme në këtë sektor, të cilat rekomandojnë një rritje të numrit të aktorëve në treg, me qëllim rritjen e konkurrenshmërisë dhe uljen e kostove për konsumatorët.

*Tregu i gazit të lëngshëm dhe problematika të tregjeve të tjera, të bëra publike nga operatorët, të cilat tregojnë brishtësinë e konkurrencës në Shqipëri*

2. Hetimit dhe zgjidhjes së problematikës së shërbimeve koncesionare, të dhëna në kushte monopoli nga Qeveria dhe Kuvendi, në të cilat kostot për qytetarët janë rritur në nivele shumë më të larta se në rajon, si:

- Shërbimi i kontrollit të automjeteve;

- Shërbimi i pajisjes me pulla fiskale;

- Shërbimi i markimit të karburanteve;  
- Lotaria kombëtare;  
- Shërbimi i skanimit të kontejnerëve pranë terminalit të Portit të Durrësit.

3. Rritjes së bashkëpunimit të Autoritetit të Konkurrencës me Qeverinë, KLD-në dhe me entet e tjera përgjegjëse.

- Deri më 31.12.2013, për 71,2 për qind të gjobave të vendosura nga Autoriteti i Konkurrencës nuk është marrë një vendim nga pushteti gjyqësor.

- Është vënë re se opiniononi i Autoritetit të Konkurrencës nuk është marrë parasysh në vendime sensitive për konkurrencën në treg.

-Për mospërsëritjen e këtyre problematikave, Kuvendi i kërkon Autoritetit të Konkurrencës, organeve ekzekutive dhe gjyqësore të të gjitha niveleve të shkëmbejnë informacionin e nevojshëm për monitorimin e tregut, hetimin e praktikave që deformojnë konkurrencën dhe për konsultime të përhershme në procesin e përgatitjes dhe miratimit të akteve ligjore dhe nënligjore.

4.Rritjes së transparencës së Autoritetit të Konkurrencës ndaj Kuvendit, Qeverisë, si dhe ndaj publikut të gjerë.

KRYETARI  
Ilir Meta

Miratuar në datën 29.5.2014

## NJOFTIM PËR VEND PUNE

Në zbatim të ligjit nr. 152/2013, datë 30.5.2013 “Për nëpunësin civil”, kreu IV – “Pranimi në shërbimin civil”, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë njofton se në administratën e tij *ka vend të lirë pune, në pozicionin “specialist finance”, në Shërbimin e Financës dhe Buxhetit.*

-Konkurrimi do të bazohet në njohuritë për specialitetin, Kushtetutën, ligjin “Për nëpunësin civil”, Kodin e Procedurave Administrative, si dhe të legjislacionit për organizimin dhe funksionimin e Kuvendit.

Kandidati duhet të ketë njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike; aftësi për të integruar informacionin me politikat institucionale, aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, për të dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale, aftësi për të vlerësuar opsione politikash dhe për të parashikuar pasojat nga përzgjedhja e tyre.

-Konkursi do të kalojë në këto faza: dorëzimi i dokumentacionit brenda 30 ditëve kalendarike nga shpallja; verifikimi i kandidatëve që plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta - pas 5 ditë pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit dhe shpallja e listës së kandidatëve që kualifikohen për në fazën e dytë; testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë.

-Konkurrimi do të bëhet për 1 (një) vend të lirë pune.

**- Kërkesat e përgjithshme për këtë vend pune janë:**

-Të jetë shtetas shqiptar.

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.

- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.

- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.

- Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.

- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji.

- Përshkrimi i përgjithshëm i punës: Të realizojë dhe të kontrollojë kryerjen e pagesave të pagave, shpërblimeve, shpenzimeve të deputeteve dhe sigurimeve shoqërore, bazuar në legjislacionin në fuqi.

**- Kërkesat e veçanta për këtë vend pune janë:**

- Të ketë diplomë universitare bachelor dhe master profesional/shkencor, në ekonomi ose ekonomi-financë.

- Të ketë përvojë në punë deri në një vit.

-Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi, në Shërbimin e Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të Deputetëve të Kuvendit (njësia përgjegjëse), këto dokumente: letër motivimi për aplikim në vendin vakant; një kopje të jetëshkrimit (CV ); fotokopje e diplomës- nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njëzuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin; fotokopje e listës së notave - nëse ka një diplomë dhe listë notash, të ndryshme me vlerësimin e njohur në shtetin shqiptar, atëherë aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar; një fotokopje e librezës së punës e plotësuar; vërtetim i gjendjes gjyqësore; certifikata të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme; fotokopje e letërnjoftimit.

-Pranimi i dokumenteve do të bëhet deri në **datën 5.7.2014.**

-Në datën 14.7.2014 do të shpallet lista e vlerësimit paraprak të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurrimin, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Kuvendit dhe në stendën e informimit të publikut.

Këta do të jenë ata që plotësojnë të gjitha kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të kërkuara më sipër.

-Ankesat nga kandidatët paraqiten në njësinë përgjegjëse, brenda 5 ditëve kalendarike nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

-Konkurrimi-*testimi me shkrim* do të bëhet në **datën 7.8.2014**, në mjediset e Kuvendit, në orën **10-00.**

-Kandidatët do të vlerësohen nga Komiteti i Përhershëm i Pranimi, i ngritur pranë institucionit të Kuvendit të Shqipërisë. Totali i pikëve të vlerësimit të

kandidatit është 100, të cilat ndahen përkatësisht: vlerësimi i jetëshkrimit - **15 pikë**, intervista e strukturuar me gojë - **15 pikë** dhe testimi me shkrim - **70 pikë**.

-Pas përfundimit të vlerësimit të testit me shkrim, kur kandidati merr 40 pikë e lart, ai i nënshtrohet intervistës së strukturuar me gojë.

-Lista e fituesve nga 70 pikë e lart do të shpallet në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Kuvendit dhe në stendën e informimit të publikut, në datën 8.8.2014.

Për sqarime, mund të kontaktoni me numër telefoni 2278 270 dhe 2278 425 ose në adresën: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 4, Tiranë.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2014

Çmimi 8 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",  
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006